



POLICY BRIEFS

KOSOVO

April 2015

www.kas.de/kosovo

Kuptimi i marrëdhënieve midis medieve dhe religjionit në Kosovë

Jeta Abazi Gashi

University of Prishtina

Hyrje

Temat mbi religjionin janë joshëse për tu raportuar nga mediet, janë tema që nuk varen vetëm nga temat aktuale apo koha e raportimit, prandaj kurdo që raportohen gjejnë hapësirë në medie. Në Kosovë mediet dhe funksionet e tyre janë pak të studiuara dhe veçanërisht raportet në mes medieve dhe religjionit.

Mediet duhet të kenë guximin e trajtimit edhe të temave që janë të ndjeshme apo tema të konsideruara tabu për shoqëritë. Guximi i tyre është tregues i pavarësisë dhe demokracisë së medieve. Por, rëndësia e rolit informues që kanë mediet varet nga raportimi i saktë, korrekt dhe i paanshëm. Për cilado tema kur mediet nuk respektojnë këto parime, sjellin keqinterpretim, keqinformim dhe shtrembërim të realitetit, kështu edhe për temat mbi religjionin.

Kushtetuta dhe ligjet e Kosovës e garantojnë lirinë fetare, e promovojnë tolerancën dhe nuk e lejojnë "nxitjen dhe provokimin e dhunës dhe armiqësive në baza [...] fetare". Radiot dhe televizionet mbikëqyren nga trupa shtetërorë, ndërsa shtypi është mbikëqyruar nga Këshilli për Media të Shkruara, një trup vetë-rregullativ i cili është formuar me vullnetin e disa redaktorëve dhe gazetarëve. Mediet elektronike (gazetat elektronike) hyjnë nën petkun e trupit të fundit, ndërsa portalet informative nuk kontrollohen apo monitorohen nga asnjë mekanizëm.

Religjioni dhe mediet janë në zhvillim dhe ndryshim të vazhdueshëm. Andaj duhet të ketë përditësim dhe ndryshim të rregullt të qasjes ndaj këtyre temave. Kërkohet një angazhim nga të gjithë protagonistët, filluar nga institucionet qeveritare, shoqëria civile dhe mediet, në mënyrë që kemi promovim të tolerancës fetare. Toleranca e religjionit e promovuar në medie është një tango që duhet të luhet me përkushtimin e të dyja palëve, medieve dhe religjionit.

Mediet e kanë fuqinë që të promovojnë tolerancën fetare apo edhe të nxisin urrejtjen ndaj një feje apo etnie të caktuar. Prandaj duhet të ketë takime dhe debate për këto tema. Një shembull i mirë i organizimeve të tilla janë takimet e fondacionit gjerman KAS (Konrad-Adenauer-Stiftung), të cilët që

nga viti 2012 për çdo vit mbledhin përfaqësues nga Bashkësia Islame, Kisha Katolike dhe Kisha Ortodokse dhe diskutojnë për tolerancën fetare, sfidat dhe nevojat për informim, sidomos për informimin e të rinjve. Një nismë tjetër është bërë edhe nga Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës dhe mbështetësve të tjerë ndërkombëtarë. Organizimi i një sërë takimesh dhe krijimi i një portali zhvillohen nën petkun e quajtur Inferfaith Kosova, i cili synon të promovojë tolerancën fetare në Kosovë¹.

Kjo analizë e shkurtë synon t'i përgjigjet pyetjeve si: Si duhet mediet të raportojnë për temat e religjionit? A janë mediet në Kosovë duke respektuar standardet dhe etikën gazetare? Si ka ndryshuar roli i medieve për shkak të zhvillimit të medieve të reja (medie sociale)? Pse temat për religjionin janë joshëse dhe si po trajtohen nga mediet në Kosovë?

Po ashtu, analiza synon që të ofrojë sugjerime konkrete për përfaqësuesit e medieve, institucionet të cilat monitorojnë dhe mbikëqyren punën e medieve, si dhe për përfaqësuesit e religjioneve.

1.2. Tradita e jetës së përbashkët fetare në Kosovë

Toleranca fetare në Kosovë është e garantuar me kushtetutën dhe me ligjet e vendit. Kushtetuta garanton lirinë e besimit dhe të fesë², se nuk do të ketë asnjë fe zyrtare si dhe që Bashkësitë Fetare janë të ndara nga autoritetet publike. Ligji për Tolerancën fetare³, i miratuar në 2006, trajton edhe raportet ndërmjet medieve dhe bashkësive fetare. Në mediet publike bashkësitë fetare gëzojnë qasje të barabartë dhe kanë të drejtë që të publikojnë informata duke përdorur të gjitha format e medieve.

Medieve në Kosovë kryesisht u mungojnë rregulloret, kodet e mirësjelljes, rregulloret për politikën editoriale

¹ Për më tepër vizito ueb faqen zyrtare të Interfaith Kosova, vegëza: interfaithkosovo.org/?lang=Al

² Kushtetuta e Kosovës, qasur më 12 prill 2015, vegëza: kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf

³ Ligji për Tolerancën Fetare në Kosovë, marrë nga ueb faqja zyrtare e Kuvendit të Kosovë 10 prill 2015, vegëza: http://kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006_02-L31_al.pdf

apo etike, të cilat do të mund të përcaktonin apo sqaronin raportimin për çështje të ndryshme si dhe përkitazi me religjionin, qoftë edhe në sqarimin e përdorimit të vetëm një fjale të caktuar. Pesha që mund të sjell një fjalë apo fjali e raportuar në media është e madhe, ajo mund të shkoj deri tek ekstremizmi dhe thirrja për të bërë aksione ndaj ndonjë grupi fetar, prandaj nuk duhet të kalojnë pa u kërkuar llogaridhënie prej medieve.

Në rastin e Kosovës, televizioni i vetëm publik rregullohet me ligj të veçantë dhe dokumentin për standardet etike dhe profesionale të RTK. Në bazë të ligjit, RTK nuk mund të transmetojë asnjë material, i cili me përmbajtjen, nëntekstin, dykuptimësinë, aludimin ose edhe me tonin, nxit diskriminim në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës dhe fesë⁴. RTK mund të transmetojë informata dhe ngjarje me përmbajtje religjioze, me kusht që këto programe:

të mos e portretizojnë, karakterizojnë dhe eksponojnë një religjion superior ndaj tjetrit; të mos shpotisë, përçmojë dhe denigroj ndonjë religjion; të mos ndikojë, në mënyrë të qartë e të çiltër anëtarësim në ndonjë organizatë religjioze, rrjedhimisht të mos e promovojë anëtarësimin dhe predikimin në të; të mos përmbajë mesazhe të promovimit religjioz-politik⁵.

Sipas standardeve profesionale dhe parimeve etike për RTK-në sqarohet edhe paanshmëria e gazetarëve, përmbajtja e programeve religjioze, paraqitja e religjionit dhe grupeve religjioze e deri tek kujdesi i imponimit apo ofendimit në reklamim dhe promovim. Se sa respektohen në praktikë ligji për RTK-në dhe dokumenti për standardet profesionale kërkon një studim tjetër. Meqenëse RTK paguhet nga taksapaguesit kosovar dhe anëtarët e bordit të tij zgjedhën nga Kuvendi i Kosovës, kjo e bën edhe më akute nevojën për të kërkuar llogaridhënie, por llogari duhet kërkuar edhe nga mediet tjera private. Komisioni i Pavarur për Medie i cili mbikëqyr dhe licencën të

gjithë transmetuesit audio-vizual në Kosovë, e ka të sqaruar çështjen e paragjykitimit fetar, ndonëse edhe ky institucion njëjtë sikurse RTK do të duhej të përditësonte përcaktimet për religjionin, duke marrë parasysh që temat e religjionit po ndryshojnë. Po ashtu, pjesa e përgjegjësisë për medie elektronike do të duhej të trajtohej me seriozitet krahas zhvillimit rapid që po ndodh. Këshilli i Medieve të Shkruara e ka të hartuar Kodin e Mirësjelljes për Shtyp, qëllimi i të cilit është që t'i shërbejë shtypit kosovar moralisht dhe profesionalisht. Kodi sqaron që nuk duhet të ketë trajtim me paragjykim të një individi apo grupi mbi baza të përkatësisë etnike, religjioze etj. (...) ose përdorim të shprehjeve denigruese me qëllim të lëndimit dhe kërcënimit të një individi apo grupi mbi baza etnike, religjioze etj. Mirëpo, ky organ përveç rolit të vetëdijesimit për media nuk ka kompetenca tjera.

Dy ngjarjet të cilat do të mund të tregonin që audienca është e etur për pamje të cilat tregojnë tolerancë fetare është fotografia gjatë vizitës së Papa Françeskut më 22 shtator 2014 në Tiranë. Një klikim në "google" më fjalët kyçe "vizita papa Françesku në Shqipëri" sjell 71,700 rezultate, krahasuar me fjalët kyçe për vizitën e ish-presidentit amerikan George W. Bush në Tiranë, për të cilin dalin 34,400 rezultate. Fotografia në të cilën shihet Papa Françesku në sfond me tre udhëheqësit fetarë, mysliman, bektashi dhe ortodoks, dhe prapa tyre mijëra qytetarë me telefona të mençur duke kapur momentin⁶ pushtuan mediet dhe rrjetet sociale në Kosovë. Rastin e dytë të cilën po e sjell për lexuesin besoj që është edhe më i njohur, transmetimi i parakalimit krah për krah i katër udhëheqësve fetarë shqiptarë në Paris, që erdhi fill pas ngjarjes tragjike të vrasjes së redaktorëve dhe gazetarëve të revistës satirike "Charlie Hebdo". Vetëm në kanalën "youtube" një video e këtij parakalimi ka marrë 13,700 klikime dhe ka pasur një mbulueshmëri të konsiderueshme nga mediet kosovare.

Toleranca fetare është e nevojshme mirëpo vazhdon të jetë temë sfiduese për Kosovën, në veçanti edhe për mediet. Frika nga ekstremizmi ka bërë që institucionet dhe shoqëria civile ta shohin nevojën për ta luftuar këtë

⁴ Ligji për RTK-në, marrë nga ueb faqja zyrtare e RTK-së. Qasur më 12 Prill 2014, vegëza: rtklive.com/new/rtk/etc/ligji_rtk.pdf.

⁵ Për më tepër shih: Dokumenti për Standarde Profesionale dhe Parimet Etike të Gazetarisë në programet e RTK-së, qasur më 10 Prill 2015, vegëza: rtklive.com/rtk/standardeprofesionale_sq.pdf.

⁶ Fotografia nga Associated Press, vegëza: <http://m.deseretnews.com/photo/765660039>

dukuri. Tashmë është hartuar edhe Strategjia për Luftimin e Terrorizmit 2012-2017, në të cilën theksohet mbrojtja e qytetarëve nga ndikimi i ideologjive ekstremiste që bazohen në jo-tolerancë, urrejtje dhe dhunë për arritjen e qëllimeve politike dhe ideologjike duke keqpërdorur fenë⁷. Pozita gjeostrategjike e Kosovës përveç që krijon mundësinë për të bërë vendin tonë si cak tranziti për aktivitete ilegale, po ashtu paraqet rrezik edhe për shpërndarjen e fundamentalizmit religjioz⁸.

Mbikëqyrës evropianë nuk kanë kritikuar tolerancën fetare, për më tepër kanë vlerësuar se ka pasur progres të vazhdueshëm në fushën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë⁹. Megjithatë ka sfida. Një raport i Departamentit Amerikan të Shtetit i vë në pah disa raste të gjuhës denigruese dhe shpërndarjes së urrejtës që është bërë në medie. Predikues fetarë i përshkruanin gratë me gjuhë denigruese dhe në predikime që gjerësisht shpërndaheshin nëpërmjet internetit dhe në paraqitje në medie të ndryshme deklarorin se votimi për parti të caktuara politike është "mëkat"¹⁰.

Raportimi i medieve me një retorikë përjashtuese dhe denigruese e shton urrejtjen fetare dhe e pengon debatin mbi tolerancën fetare. Raportime të tilla duhet të jenë në përputhje me ligjet dhe rregulloret ne fuqi. Përveç reagimit të Departamentit të Shtetit amerikan, nuk ka pasur reagim nga institucione të cilat mbikëqyrin punën e medieve. Nuk njihet për publikun ndëshkimi i ndonjë mediumi për raportim të pasaktë, të pabalancuar dhe me mungesë të respektimit të etikës dhe rregullave profesionale gazetare. Deri më tani KPM nuk ka ndëshkuar ndonjë medium lidhur me mosrespektimin e Ligjit të KPM-së për shkak të

diskriminimit fetar¹¹. Në ueb faqen e Këshillit për Media të Shkruara gjenden reagimet dhe komunikata për tema të caktuara. Të dyja këto trupa kanë marrë këshilla publike nga kontribuues të medias për nevojën e përmirësimit të standardeve profesionale gazetare. Në përgjithësi, të dy institucionet duhet të jenë më të zëshme rreth sfidave aktuale etike dhe të veprojnë në përmirësimin e standardeve dhe lirisë së medias¹².

1.3. Joshja mbi temat për religjionin

Në Kosovë nuk ka ndonjë medium audio-vizual që operon vetëm në bazë të promovimit fetar. Ndërkaq, në kuadër të skemës së tyre programore disa media i kanë të përfshira emisionet me përmbajtje të edukimit fetar por që nuk mund të cilësohen si promovim fetar apo që sugjerojnë supremaci fetare në krahasim me ndonjë fe tjetër. Në bazë të Ligjit të KPM-së, licenca nuk i lëshohet partisë politike, bashkësisë fetare, grupit ose organizatës e cila menaxhohet nga individ i cili mban post të zgjedhur ose është anëtar i një organi ekzekutiv të një partie politike. Por, Ligji i KPM-së nuk e ndalon decidivisht licencimin e subjekteve audio-vizuale që mund të prezantojnë skemë programore me edukim fetar¹³. Në kuadër të skemës së ofruar nga abonentët privat, ofrohet televizioni "Peace TV" i cili është i bazuar kryekëput në edukim fetar të një feje të vetme. Mirëpo sipas KPM-së, ky subjekt me seli në Londër, është përfshirë në operatorët kabllorë Ipko dhe Kujtesa përmes një autorizimi për transmetim të cilin e ka sjellë në KPM dhe me të cilin ka dëshmuar se gëzon të drejtat për transmetim në Kosovë¹⁴. KPM e mban përgjegjësinë dhe të drejtën e largimit të një kanali nga sistemi kabllor në rast të shkeljes së ligjit ose rregulloreve të KPM-së.

⁷ Strategjia kombëtare kundër Terrorizmit, marrë nga ueb faqja zyrtare e Qeverisë së Kosovës, qasur më 9 Prill 2015, vegëza: www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_kunder_Terrorizmit_2012-2017.pdf

⁸ Ibid

⁹ Raporti i Progresit për Kosovën, 2014, marrë nga ueb faqja e MI-së, qasur më 10 Prill 2015, vegëza: www.mei-ks.net/repository/docs/IFINAL-ALB_MIE_Kosovo_Progress_Report_2013_%28alb%29_%282%29.pdf

¹⁰ Raporti ndërkombëtar për lirinë fetare për vitin 2013, Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara, marrë nga ueb faqja e ambasadës amerikane në Kosovës, qasur më 11 Prill 2015, vegëza: http://photos.state.gov/libraries/kosovo/312585/pdf/trf_2013_alb.pdf

¹¹ Intervistë me nënkryetarin e KPM-së, Driton Qeriqi. Komunikim i autorës për nevojat e kësaj analize.

¹² Rekomandime nga Fondacioni Tomson, projekti Media For All – Strengthening Media Self-Regulation, Media Law and Media Freedom in Kosovo". Qasur më 12 Prill 2015, marrë nga ueb faqja e Këshillit për Media të Shkruara, vegëza: <http://presscouncil-ks.org/?cid=1.13.525&tpl=list.php>

¹³ Intervistë me nënkryetarin e KPM-së, Driton Qeriqi. Komunikim i autorës për nevojat e kësaj analize

¹⁴ Ibid

Mediet janë burim informacioni për temat mbi religjionin, trendët e religjionit dhe idetë e religjionit¹⁵. Mediet jo vetëm që mbulojnë dhe përfaqësojnë religjionin, ato në fakt bashkëveprojnë me religjionin në mënyrë të tillë që e ndryshojnë edhe veten edhe religjionin¹⁶. Si praktikë e medieeve në Kosovë, temat mbi religjionin janë temat e raportimit të festave religjioze, për të cilat festime raportimi është klishe dhe nuk ndryshon si për festat myslimane, krishtere ashtu edhe ato ortodokse. Transmetohen mesazhe urimi të udhëheqësve fetarë ose politikë, intervista me qytetarë (parapërgatitjet festive) dhe kështu përsëriten çdo vit. Mediet duhet të kujdesen që misioni i tyre informues dhe edukativ nuk është vetëm përgjatë festave fetare dhe duhet të shfrytëzojnë festat e tilla për të ngritur probleme të cilat pengojnë tolerancën fetare në Kosovë.

Temat e raportuara për religjionin duhet të sigurojnë qasje gjithëpërfshirëse dhe duhet të respektojnë parimet e përcaktuara nga ligjet dhe rregulloret për medie.

Temat më të raportuara për religjionin në Kosovë janë temat nga raportimi i akteve vandale apo problemet ndërmjet etnive apo grupeve religjioze, raportimi për luftën në Siri, rreziku nga terrorizmi, pastaj dhe trajtimi i temave politike dhe partiake, si dhe temave sociale. Në secilën nga këto kategori raportimi do të duhej të ishte i kujdesshëm.

- Raportimi i akteve vandale: këtu mediet duhet të sigurohen që të mos ketë mbështetje të vetëm një burimi të informacionit, të kujdesen të përfshijnë të dyja anët e medaljes (anët e përfshira). Mos të ketë fajësim të një grupi të tërë dhe nëse fajësohet njëri grupi etnik apo religjioz të përfshihet reagimi i grupit tjetër. Mos të ketë gjuhë opinionuese, por informuese. Mediet raportojnë nuk gjykojnë.

- Raportimi i rasteve të luftimit në Siri: për shkak të ndjesisë së temës përdorimi i gjuhës së saktë

duhet të jetë i vëmendshëm, mos të ketë përgjithësim ose hiperbolizim të rasteve dhe mediumet duhet të kujdesen të mos e lejojnë që ta promovojnë luftimin në Siri. Përdorimi i fëmijëve në raportimet e tilla duhet t'i përmbahet etikës profesionale gazetare. Mediet nuk duhet t'i raportojnë pamjet prekëse nga vrasjet e civilëve në Siri pa dhënë paralajmërim për pamje të tilla apo nëse nuk i mjegullojnë pjesë të pamjeve.

- Trajtimi i komentimit të temave politike nga udhëheqësit fetarë: në kohë zgjedhjesh mediet duhet të kujdesen për mënyrën se si raportojnë mesazhet e udhëheqësve fetarë, të cilët nga vendet religjioze shfrytëzojnë mediet për të promovuar apo pëlqyer një parti politike.

- Përdorimi i temave sociale: në mungesë të debateve edukative për tema të ndryshme sociale, mediet duhet t'i kushtojnë rëndësi përmbajtës së këtyre trajtimeve të cilat ofrohen si debate mbi tema sociale mirëpo janë me gjuhë ofenduese ndaj një feje apo gjinie të caktuar. Mediet nuk duhet të transmetojnë fjalime apo mesazhe në të cilat përdoren për t'i ofenduar gratë, nënçmuar dhe dhënë epitete ofenduese.

Mediet kanë fuqinë që të bëjnë çështje të njohur për publikun, një temë të caktuar ose individ të caktuar. Këtë funksion që e kanë mediet që të zgjedhin tema të caktuara ose t'i japin hapësirë vetëm individëve të caktuar quhet statusi konferral. Kur mediet përdorin këtë status për tema dhe individë të caktuar, si rezultat qytetarët i ndjekin vetëm pse janë raportuar nga mediet ose iu besojnë personave, meqë mediet i kanë përzgjedhur si burime dhe i kanë besuar për të interpretuar. Prandaj, mediet duhet t'i kushtojnë rëndësi përzgjedhjes së temave dhe individëve të cilët i citojnë apo intervistojnë, për shkak se përzgjedhja e tyre nga mediet ka efekt në besueshmërinë që kanë për ta qytetarët. Përmbajtja që ata ndajnë më publikun duhet të jetë pa fyerje, ofendim apo nënçmim.

1.4. Mediet elektronike (portalet e lajmeve dhe gazetat elektronike)

Roli i medieeve në shoqërinë kosovare ka ndryshuar për shkak të zhvillimit të medieeve elektronike. Ato janë

¹⁵ *Media and Religion, The Center for Religion and Culture, University of Colorado at Boulder, USA, nga Stewart M. Hoover, qasur më 12 nëntor 2014, vegëza:*

<http://cmrc.colorado.edu/cmrc/images/stories/Center/Publications/whitepaperfinalversion.pdf>

¹⁶ *Ibid*

duke dominuar informimin dhe tregun medial. Përparësitë e medieve e elektronike janë të mirëpritura në gazetari, për shkak të mundësisë së qasjes në kohë dhe vende të ndryshme si dhe për shkak të interaktivitetit që mund të kenë më publikun. Mirëpo, mediet elektronike në Kosovë përballen më disa vështirësi të cilat ndikojnë seriozisht në informimin e publikut. Mungesa e burimeve, mungesa e verifikimit dhe redaktimit dhe mos kontrollimi i komenteve ndikojnë në cilësinë dhe vërtetësinë e lajmeve. Portalet që nuk joshen nga shpejtësia si pasojë janë më pak të vizituara ose klikuar prej lexuesve.

Në krahasim me mediet tradicionale (radiot, gazetat dhe televizionet), mediet e reja (portalet lajmore dhe gazetatat elektronike) janë edhe më të varura nga nevoja për të përshpejtuar me lajmin. Shpejtësia në informim mund të sjell pasaktësi dhe keqinformim. Ndërsa për temat e religjionit mund të nxis urrejtje ose dhunë.

Portalet përballen edhe me problemin e mungesës së burimeve, ose përdorimit të vetëm një burimi. "U arrestua muaj më parë si i dyshuar për terrorizëm po del të jetë një gabim i madh i qeverisë Kosovare"¹⁷. Ky lajm është konstatues dhe nuk ka asnjë burim të përdorur në tekst. Lajmet një burimore e shkatërrojnë objektivitetin në gazetari dhe nuk mund të informojnë paanshëm. Kështu krijohet një mjegulli se a janë duke informuar portalet apo duke komentuar. Duhet të dallohen informimi dhe komentimi. Ka mjaft tituj të lajmeve në gazetarinë elektronike që janë me gjuhë komentuese. P.sh., "Tronditet Serbia, vajza që u konvertua në myslimane"¹⁸. Ka raste kur publikohet një deklaratë, foto, video dhe nuk kontrollohet përmbajtja e materialit nëse përmban gjuhë nënçmuese, ofendon një etni apo fe të caktuar dhe bënë një fe më superiore sesa ndonjë tjetër, sikurse është deklarata, "jemi bë ma zi se [term ofendues për serbët]"(...) ¹⁹.

¹⁷ Për më tepër lexo artikullin i cili nuk ka asnjë burim të deklaruar dhe gjuhë komentuese: indexonline.net/?FaqelID=2&LajmID=148054

¹⁸ Për më tepër lexo artikullin i cili ka titull komentues dhe bazohet vetëm në një burim, vegëza: telegrafi.com/lajme/tronditet-serbia-vajza-serbe-u-konvertua-ne-myslimane-video-4-24232.html

¹⁹ Për më tepër lexo lajmin në : gazetaexpress.com/lajme/hoxhe-irfani-puthe-puthe-puthevideo-31715/?utm_source=referral&utm_medium=ëeb&utm_campaign=copyright

Jo të gjitha portalet në Kosovë i moderojnë komentet e lexuesve, që do të thotë se çdokush mund të shkruajë çfarëdo drejt një feje. Gjuha e përdorur në komente është ofenduese, nxitëse dhe pengon zhvillimin e tolerancës fetare që është i mirëpritur nga mediet. Në raportimet për temat mbi religjion, komentet fillojnë nga ofendimi ose fyerja e një feje e deri tek thirrjet për vrasje. Portalet nuk mund të arsyetohen që nuk është përgjegjësi e tyre gjuha e komenteve, për shkak se ato bëhen në kuadër të portaleve dhe kështu ata nuk mund t'i ikin përgjegjësisë. Disa portale kanë bllokuar të drejtën për të komentuar, por numri i portaleve që i filtrojnë komentet është i vogël. Përgjegjësia e portaleve për pjesën e komenteve të lexuesve është konfirmuar në një vendim²⁰ të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në atë vendim, Gjykata madje kërkon që në raste të caktuara portalet të mos publikojnë fare komente e jo vetëm t'i largojnë ato pasi të jenë publikuar, në rast se janë ofenduese, etj.

1.5. Konkluzione:

Analiza ofron sugjerime për gazetarë, redaktorë, udhëheqës të medimeve, Komisionin e Pavarur për Media (KPM), Këshillin për Media të Shkruara, zyrtarë për media në Bashkësitë e ndryshme fetare:

- Nga të gjithë protagonistët duhet të kërkohej llogaridhënie në lidhje me mediet, në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi. Mungesa e dënimeve tregon që puna nuk është duke u kryer si duhet.
- Gazetarët dhe redaktorët në Kosovë duhet të kujdesen që raportimi për religjionin të jetë i balancuar dhe gjithëpërfshirës, në mënyrë që të mos nxisin urrejtje ndaj një feje të caktuar. Të mos lejojnë gjuhë ofenduese si për fetë ashtu edhe ndaj një gjinie.
- KPM duhet t'i monitorojë shërbimet audio-vizuale në Kosovë dhe raportet e konkludimet t'i bëjë të qasshme edhe për publikun.

²⁰ Marrë nga ueb faqja zyrtare e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vegëza [http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-126635#\[/itemid\]:\[001-126635"\]](http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-126635#[/itemid]:[001-126635)

- Komisioni për Media (në kuadër të Kuvendit të Kosovës) duhet të monitorojë zbatimin e kuadrit ligjor në lidhje me mediet.
- Bashkësitë Fetare duhet të kujdesen që përfaqësuesit e tyre fetarë mbajnë përgjegjësi për fjalët e tyre dhe në rast të përdorimit të gjuhës së urrejtjes, reagimi ose distancimi duhet të jetë i menjëhershëm në media.
- Këshilli për Media të Shkruara duhet të përditësojë listën e anëtarëve dhe të organizojë debate me gazetarë dhe përfaqësues të medieve për çështje të raportimit mbi çështje që lidhen me religjionin.
- Mediet elektronike duhet të investojnë që lajmet të mos kenë gjuhë komentuese, të ketë më shumë se një burim të cituar si dhe të kontrollohen materialet të cilat publikohen në portale (për gjuhë të urrejtjes fetare apo gjinore). Portalet duhet të forcojnë pozitën e redaktorëve në mënyrë që lajmi të jetë i besueshëm, i saktë dhe korrekt.
- Legjislacioni për mbikëqyrjen e medieve elektronike duhet të bëhet prioritet për shkak se mediet elektronike janë duke kontribuar në shkatërrimin e vlerave profesionale të gazetarisë.
- Mediet elektronike duhet të mbahen përgjegjëse për komentet që postohen në artikujt e botuar, në përputhje me vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Fondacioni Konrad Adenauer Konrad-Adenauer
Zyra në Kosovë
Bulevardi Nëna Terezë 30-3/6
KO-10000/Pristina
Tel. +381 (0) 38 229 874
Prishtina@kas.de
www.kas.de/kosovo

Pikëpamjet e paraqitura në këtë punim janë pikëpamje personale të autorit dhe ato nuk paraqesin patjetër qëndrimet e Fondacionit Konrad Adenauer.

Punimi origjinal është shkruar në gjuhën shqipe.